

## RELACION TEKNIK

### PËR PROJEKTIN: REHABILITIM I SHESHEVE DHE HAPËSIRAVE PUBLIKE NË TERRITORIN E BASHKISË PRRENJAS

Punimet për sistemimet e hapësirave publike do të kryhen në qytetin Prrrenjas, ndërmjet hapësirave të pallatave brenda unazës së qytetit, si dhe në ish zonën industriale të minier hekur-nikel (sheshi para ish hoteleve, sot apartamente private), si dhe në hapësira të tjera publike (sipas projektit).

Sheshet që do të sistemohen janë hapësirat ndërmjet pallatave që kufizohen nga rruga Blerimi deri te rruga 1 Maji, hapësirat ndërmjet pallateve nga rruga 1 Maji deri te rruga Minatori hapësirat ndërmjet pallatave nga rruga Minatori deri te rruga 10 Nëntori.

Gjithashtu do të shtrohen trotuaret e rrugës Minatori nga qendra e qytetit deri te rruga Qybra Sokoli dhe trotuari rinia nga rruga Minatori deri te rruga 10 Nëntori.

Objektet që do të rehabilitohen janë:

- Blloku banimit Nr.1 "Sheshi ndërmjet pallateve 2kt " Sip = 500m<sup>2</sup>
- Blloku banimit Nr.1 "Sheshi ndërmjet pallateve 5kt " Sip = 350m<sup>2</sup>
- Blloku banimit Nr.1 "Sheshi ndërmjet pallateve 5kt " Sip = 350m<sup>2</sup>
- Rikonstruksion i trotuarve "RRUGA MINATORI" Sip = 827m<sup>2</sup>
- Blloku banimit Nr.2 "sheshi ndërmjet pallateve 3kt " Sip = 1349m<sup>2</sup>
- Rikonstruksion i trotuarve "RRUGA RINIA" Sip = 464m<sup>2</sup>
- Hapësirë e blloqeve të pallateve tek ish hotelet zona industriale Prrrenjas Sip = 460m<sup>2</sup>

Vendi i ndertimit --Qyteti Prrrenjas.

- I- Gjendja aktuale e shesheve ndërmjet pallateve është shumë e amortizuar, këto sipërfaqe nuk janë shtruar ndonjëherë që me krijimin e qytetit, rehabilitimi i shesheve dhe hapësirave publike ndërmjet pallateve krijon një infrastrukturë të re për qytetaret.
- II- Baza materiale për shtrimin e hapësirave, shesheve dhe rikonstruksionin e trotuarëve është e bashkisë Prrrenjas e siguruar nga marrveshja me F.ZH.SH.
- III- Punimet për pastrimin dhe sistemimin e shesheve dhe trotuarëve do të kryhen nga punonjësit e drejtorisë shërbimeve pranë bashkisë Prrrenjas.

- IV- Baza materiale ( pllaka betoni 20x10x60 cm ) ne çdo shesh e trotuar do te dergohet nga bashkia Prrenjas
- V- Baza materiale pllaka e çimeto do te monitorohet nga komisioni i monitorimit te projekteve qe zhvillohen ne bashkepunim me F.ZH.SH.
- VI- Ne perfundin te realizimit te punimeve ne çdo objekt do te rakordohen volumet e materialeve te perdorura .
- VII- Çdo shesh do te shtrohet dhe do te dozohet nga subjekti ndertues i kompletuar , shtrim pllake dhe ndertim kundra bordure.
- VIII- Para fillimit te shtrimit te pllakave do te behet nivelimi i sheshit nga subjekti ndertues duke ju referuar hyrjes se apartamenteve .
- IX- Njekohesisht me shtrimin e pllakave do te behet dhe ngritja e pusetave te ujrave te zeza.
- X- Materiali per nivelimin e sheshitt do hapet ,ngjishet, nivelohet nga subjekti ndertues.
- XI- Punimet për shtrimin dhe rehabilitimin e shesheve do të koordinohen me punimet që do të kryejne punonjësit e drejtorise së sherbimeve te bashkisë Prrenjas.

Përgatiti Dr.Urbanistikës

Hymet Karriqi

Merita Balla

Dr.Urbanistikës Merita Pali